



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:044664
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05876236

Ac.nr.1142/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.V. nga Gjilani, rr. "...", nr..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.M., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson B.M., me objekt të kontestit pagesa e shpenzimeve për ushqim dhe udhëtim, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.780/20, të datës 17.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.780/20, i datës 17.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.780/20, të datës 17.11.2021, ka vendosur si në vijim: I. **APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.V.i nga Gjilani dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale për Arsim në Gjilan, që paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2.199,80 € edhe atë: - në emër të shpenzimeve për ushqim për periudhën prej 18.04.2017 deri më 16.04.2021, pra për 647 ditë pune, shumën nga 2 € në ditë, përkatësisht shumën prej 1.294,00 € dhe – në emër të shpenzimeve për udhëtim 70 % të çmimit të biletës së autobusit, për periudhën prej 18.04.2017 deri më 16.04.2021, përkatësisht për 647 ditë pune nga 1.40 € në ditë, që i bie shumën prej 905,80 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur të njëjtën që nga dita e ushtrimit të padisë, përkatësisht datës 07.04.2020, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi; II. **OBLIGOHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 270,20 €, në afat prej 7 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar, të prish aktgjykimin C.nr.780/20, të datës 17.11.2021 si të pa bazuar ose ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ose ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe rastin ta kthejë në rigjykim/ rivendosje.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, me të cilën ka propozuar që Gjykata e Apelit ankesën e të paditurës ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin C.nr.780/20, të datës 17.11.2021 ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, kundër të paditurës ka parashtruar padi me datën 07.04.2020, për kompensimin shpenzimeve të rrugës dhe ushqimit në punë, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 01.11.2021, përkatësisht në seancën për shqyrtim kryesor të datës 17.11.2021, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t'ua paguaj shumat dhe kamatën vjetore si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.780/20, të datës 17.11.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vërtetimet e lëshuara nga SHFMU "Fetah Qerimi" në Vërbicë të Zhegocit, është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si dhe që i njëjti gjatë periudhës 18.04.2017 deri me datën 16.04.2021 ka realizuar gjithsejtë 647 ditë. Po ashtu, gjykata potencon se është vërtetuar që paditësi i është drejtuar të paditurës me datën 05.03.2020 për pagesën e shumave të kërkuara me padi, si dhe është vërtetuar që bileta e autobusit në relacionin Gjilan – Vërbicë e Zhegocit ka qenë 1.00 € një drejtim. Gjykata e shkallës së parë thekson se ka vepruar konform nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit për një ditë të pranisë në punë njihet shuma 2.00 €, ashtu që paditësit për 647 ditë prani në punë gjatë periudhave të lartcekura x 2.00 € i ka njohur kompensimin në shumën 1.294,00 €. Ndërsa lidhur me shpenzimet e udhëtimit ka vepruar konform nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit punonjësit arsimor që udhëton në vendbanimet e komunës përkatëse i paguhet 70 % e biletës së trafikut urban, ashtu që për 647 ditë punë nga 1.40 € në ditë, i ka njohur kompensimin në shumën 905,80 €. Nga këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësve t'iu kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të

aktgjykimit të ankimuar. Gjykata vendimin mbi lartësinë e kamatëvonesës e ka arsyetuar konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës konform nenit 451 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin dhe së gjykata ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadsisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që përmes provave të administruara është vërtetuar se fakti paditësi është i punësuar tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Fetah Qerimi” në Vërbicë të Zhegocit, fakti që kjo e fundit nuk i ka ofruar paditësit ushqim në punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër me të cilën do të lirohej nga obligimi i kompensimit të shpenzimeve të ushqimit ndaj paditësit, si dhe fakti se paditësi gjatë periudhës 18.04.2017 deri me datën 03.03.2021 ka realizuar 647 ditë pune, për të cilat sipas nenit 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit i takon kompensim për ushqim 2.00 € për çdo ditë pune, si dhe kompensim për udhëtim në 70% të vlerës së biletave të trafikut urban, vlera e të cilave për relacionin Gjilan – Vërbicë e Zhegocit në rastin konkret është vërtetuar nga shoqata për transportin e udhëtarëve “A.”.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, përkatësisht me datën 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditësit kanë realizuar ditët e punës siç janë të theksuara më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga Shkolla Filllore e Mesme të Ulët “Fetah Qerimi” në Vërbicë të Zhegocit, ndërsa e paditura nuk u ka ofruar paditësve ushqimin gjatë punës përmes restorantit, kuzhinës apo në

ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë. Po ashtu, bazë të nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë nga vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, rezulton se për ditët e punës të theksuara më lartë, për shpenzimet e udhëtimit në relacionin Gjilan – Vërbicë e Zhegocit në shumën 2.00 € vajtje ardhje, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka njohur paditësit kompensimin e 70% e vlerës së biletave të trafikut urban për ditët e realizuara në punë. Duhet theksuar se këto çështje në mënyrë të njëjtë këtë i ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017. Thënë kjo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, andaj vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti se ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes”*. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënëse e paditësit, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t’ia bëjë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave, që buron nga Kontrata Kolektive, është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësit dhe detyrimin e të paditurës.

Lidhur me pretendimin së kërkesa e paditësit është vjetërsuar bazuar në nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, pasi që paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme para se të dorëzohet padia në gjykatë, Gjykata e Apelit gjeti se ky pretendim nuk qëndron, pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesën e datës 05.03.2020 me të cilën ka kërkuar nga e paditura kompensimin shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, e pastaj ka ushtruar padi në gjykatë. Për me tepër, kjo

gjykatë vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësit t’ia paguaj kompensimin për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësi t’i drejtohet me kërkesë, sepse në rastet kur kemi të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuarit, në këtë rast paditësi, për realizimin e të drejtës së tij t’i drejtohet gjykatës me padi.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 451 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1142/2022, datë 13.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci